

KOMENT MBI LIGJIN PËR NDËRMARRJET PUBLIKE DHE SHOQËRITË TREGTARE NË PRONËSI, OSE ME PJESËMARRJE, TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Agjenda reformuese për Republikën e Maqedonisë së Veriut parashikon një paketë reformash për menaxhimin e ndërmarrjeve publike dhe të shoqërive tregtare në pronësi shtetërore, duke përfshirë përgatitjen e një ligji të ri, një strategjie dhe një regjistri. Sipas sekuencës së parashikuar, këto masa duhet t'i paraprijnë rristurimit të sektorit postar dhe hekurudhor¹. Çështjet që, në përputhje me Agjendën Reformuese, duhet të përfshihen në ligj dhe në strategji përfshijnë zgjedhjen e bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse, publikimin e raporteve financiare, menaxhimin e rrezeve dhe përcaktimin e treguesve kyç të performancës².

Instituti për Demokraci "Societas Civilis" (IDSCS), nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës (MEP), u ftua të marrë pjesë në grupin e punës për hartimin e ligjit dhe të strategjisë për ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi ose me pjesëmarrje të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në tetor të vitit 2025. Në janar 2026, u botua një projektligj për ENER³, dhe brenda grupit të punës për disa versione të propozim - ligjit, u paraqit një tekst i ndryshuar më 23 qershor 2026, i cili, sipas MEP, është një tekst i harmonizuar me Bashkimin Evropian. Ky version i ligjit nuk u diskutua në mënyrë thelbësore brenda grupit të punës. Ligji u miratua me procedurë të shkurtuar në Kuvend, më 30 qershor 2026, pa debat të duhur publik⁴. Qëndrimet e paraqitura në këtë dokument, në masë të madhe, janë shprehur dhe mbrojtur nga ana jonë edhe në kuadër të grupit të punës, duke pasur parasysh se versioni i miratuar i ligjit nuk dallon në mënyrë thelbësore nga versionet e mëparshme.

Ligji vendos objektiva financiare dhe jofinanciare, rrit transparencën financiare dhe përmirëson kontrollin e brendshëm dhe revizionin të ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi ose me pjesëmarrje të shtetit, ndërsa parashikon edhe detyrimin për mbajtjen e një evidence të detajuar dhe publike të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi shtetërore, përfshirë edhe pjesëmarrjet minoritare, gjë që përbën një risi të rëndësishme dhe pozitive.

Ligji, nga ana tjetër, prezanton një instrument të ri të quajtur politika e të drejtave të pronësisë, duke iu referuar udhëzimeve të OECD-së për qeverisjen e korporatave të ndërmarrjeve shtetërore. Këto standarde rekomandojnë që pronari shtetëror të miratojë dhe publikojë një

¹ Masat 4.1.5 të Agjendës së Reformave. E qasshme në: <https://mep.gov.mk/mk-MK/eu-integracii/plan-za-rast-za-zapaden-balkan-i-reformska-agenda/reformska-agenda-na-severna-makedonija-2024-2027-godina>

² Agjenda reformuese e Maqedonisë së Veriut vitet 2024-2027. E qasshme në: <https://portal.mdt.gov.mk/post-body-files/reformska-agenda-na-severna-makedonija-2024-2027-godina-file-Nhp6.pdf> 107

³ Propozim - ligji për ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi ose me pjesëmarrje të Republikës së Maqedonisë së Veriut (27.1.2026). Publikuar në: https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=117080

⁴ Ligji për ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi ose me pjesëmarrje të Republikës së Maqedonisë së Veriut (i miratuar nga Kuvendi më 30.6.2026). E qasshme në: <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=527634e5-6f67-480c-893d-abd0b9e3efa9>

politikë pronësie dhe të rishikojë rregullisht justifikimin e çdo pronësie individuale⁵. Sipas ligjit të miratuar, shteti duhet të arsyetojë pronësinë ose pjesëmarrjen e tij, duke iu referuar të paktën njërit prej kritereve për pronësi dhe pjesëmarrje, siç janë: menaxhimi i të mirave me interes të përgjithshëm, menaxhimi i infrastrukturës dhe rrjeteve shpërndarëse në të cilat infrastruktura fizike përbën monopol natyror, veprimtaria afariste që përfshin ofrimin e shërbimeve publike, ndikimi mbi buxhetin e shtetit, ushtrimi i aktiviteteve tregtare që kontribuojnë në stabilitetin dhe zhvillimin e ekonomisë, si dhe veprimtari të tjera me interes publik⁶. Në rastet kur shteti nuk mund të arsyetojë pronësinë ose aksionet, ai duhet të lërë strukturën e pronësisë ose pjesëmarrjen në ato subjekte juridike⁷, pra t'i tjetërsojë ato⁸. Ligji parashikon detyrimin e shtetit për të rishikuar politikat e të drejtave të pronësisë të paktën çdo 4 vjet⁹. Zgjidhje të ngjashme, gjithashtu të lidhura me Agjendën Reformuese për Ballkanin Perëndimor, vërehen edhe në ligjet e miratuara së fundmi në vende të tjera kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian.¹⁰ Megjithatë, vërejtjet e mëposhtme tregojnë se ligji nuk siguron garanci të mjaftueshme institucionale kundër rreziqeve të keqpërdorimit, të dokumentuara në përvojën maqedonase me transformimin e pronësisë, por njëkohësisht e vënë në dyshim edhe nevojën për tjetërsim, nëse përdoren argumente si mungesa e rentabilitetit dhe menaxhimi i dobët.

PROBLEMI NUK ËSHTË PRONËSIA, POR MENAXHIMI

Shkaqet e performancës së dobët. Mbështetësit e privatizimit shpesh nisen nga supozimi se subjektet në pronësi shtetërore që operojnë me humbje automatikisht duhet të konsiderohen të pajustificuara dhe t'i nënshtrohen tjetërsimit. Ne nuk pajtohemi me këtë supozim për dy arsye. Së pari, një pjesë e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi shtetërore me qëllim punojnë me humbje ose në kufirin e rentabilitetit, sepse funksioni i tyre është të mundësojnë qasje universale në një shërbim bazë me çmim të përballueshëm, në vend që ta rrisin çmimin për realizimin e fitimit (p.sh. furnizimi me ujë, menaxhimi i mbeturinave). Është pozitive që ligji parashikon kritere për pronësinë dhe pjesëmarrjen, siç janë menaxhimi i të mirave me interes të përgjithshëm dhe veprimtaria afariste që përfshin ofrimin e shërbimeve publike, të cilat krijojnë bazë për ruajtjen e këtyre subjekteve, duke pasur parasysh rolin e tyre social. Së dyti, një pjesë e arsyeve për rezultatet e dobëta financiare qëndron në praktikën e emërimit të kuadrove joprofesionale ose partiake në pozita drejtuese, dhe jo në vetë natyrën e pronësisë publike. Kur arsyeja e performancës së dobët qëndron te cilësia e menaxhimit,

⁵OECD, Guidelines on Corporate Governance of State-Owned Enterprises, 2024 Edition. Në dispozicion në: https://www.oecd.org/en/publications/2024/06/oecd-guidelines-on-corporate-governance-of-state-owned-enterprises-2024_68fa05cd.html

⁶ Neni 12 (2)

⁷ Neni 7(2)

⁸Neni 24

⁹Neni 23 (1)

¹⁰ Ukaz o proglašenju zakona o upravljanju privrednim drustvima u vlasnistvo drzave crna gora (22 qershor 2026). Në dispozicion në: <https://www.sluzbenilist.me/propisi/395379>

përgjigjja e duhur është profesionalizimi i procedurës për përzgjedhjen e drejtimit, dhe jo tjetërsimi i pronësisë.

Analiza e efekteve. Gjatë përgatitjes së ligjit nuk i ka paraprirë një analizë e disponueshme publikisht mbi numrin e subjekteve në të cilat shteti ka pjesëmarrje të plotë ose të pjesshme, një vlerësim i vlerës së këtyre pjesëmarrjeve, si dhe asnjë simulim ose projeksion i efekteve të mundshme nga zbatimi i regjimit të ri, përkatësisht sa subjekte, në përputhje me testin për arsyeshmërinë e të drejtave pronësore, potencialisht do të duhej t'i nënshtroheshin tjetërsimit dhe cilat do të ishin pasojat sociale.

Edhe pse ligji nuk parashikon tjetërsim automatik dhe i jep bazë shtetit për të arsyetuar pronësinë dhe pjesëmarrjet e tij, megjithatë, duke u bazuar në tekstin e ligjit dhe në sekuencën e parashikuar me Agjendën Reformuese, e cila ristrukturimin e postës dhe hekurudhave e lidh pikërisht me zbatimin e ligjit të ri, është e arsyeshme të pritet se do të pasojë tjetërsimi i pasurisë shtetërore në një masë të konsiderueshme. Kjo do të ndodhë në kuadër të një procedure, elementet kryesore të së cilës, të përshkruara më poshtë, nuk ndryshohen në mënyrë që të sigurohet mbrojtje nga keqpërdorimet e valëve të mëparshme të transformimit të pronësisë.

Përvoja e mëparshme negative vendase dhe krahasuese në lidhje me rreziqet e korrupsionit gjatë privatizimit. Proceset e mëparshme të transformimit të kapitalit shoqëror dhe shtetëror në RMV u shoqëruan me rreziqe korruptive: tregtim me informacione, ulje të qëllimshme të vlerës së vlerësuar, negociata të drejtpërdrejta jotransparente etj. Literatura krahasuese tregon se mungesa e procedurave konkurruese dhe transparente, si dhe e mbikëqyrjes së pavarur institucionale gjatë tjetërsimit të kapitalit shtetëror, lidhet me rrezik të shtuar për keqpërdorime, veçanërisht në transaksionet e mëdha.

MASA MBROJTËSE TË PAMJAFTUESHME KUNDËR KEQPËRDORIMIT NË SHPRONËSIMIN E KAPITALIT SHTETËROR

Centralizimi i vendimmarrjes për tjetërsimin në duart e pushtetit ekzekutiv. Ligji parashikon që ministritë kompetente i paraqesin propozim Qeverisë, e cila më pas vendos për disponimin me aksione, pjesëmarrje në kapital dhe të drejta themeluese. Ligji parashikon konsultime me institucionet e prekura dhe partnerët socialë në fazën e përgatitjes së politikës për të drejtat pronësore¹¹ – i njëjti proces në të cilin, me kërkesën tonë, u përfshi edhe Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, kjo procedurë konsultative i referohet politikës së të drejtave pronësore në tërësi, e jo vendimit konkret për tjetërsimin e një subjekti të veçantë, i cili mbetet kompetencë ekskluzive e Qeverisë¹². Procesi konsultativ në nivel të politikës, rrjedhimisht, nuk përkthehet në kontroll në nivel të vendimit konkret. Kështu, pasi politika të jetë miratuar, vendimi për tjetërsimin konkret mund të merret pa zbulim shtesë të informacionit, pa presion publik dhe pa mbikëqyrje të jashtme, pikërisht në fazën ku rreziku i

¹¹Neni 22(3)

¹²Neni 25

keqpërdorimit është më i lartë. Siç mund të vërehet, ekziston një centralizim i plotë i vendimmarrjes në duart e pushtetit qendror, përkatësisht Kuvendi është i përjashtuar nga procesi i vendimmarrjes. Sipas nesh, vendimin përfundimtar për tjetërsimin (në të gjitha ose në raste të caktuara) duhet ta marrë Kuvendi, mbi bazën e mendimeve paraprake të dhëna nga organet mbikëqyrëse dhe të pavarura, pas kryerjes së një analize të efekteve sociale të tjetërsimit dhe pas mbajtjes së konsultimeve publike. Pozitive është fakti që teksti përfundimtar, ndryshe nga versionet e punës, gjatë miratimit të politikës për të drejtat pronësore, si dhe gjatë propozim-vendimit për disponimin me aksione, pjesëmarrje në kapital dhe të drejta themeluese, përmban detyrime për arsyetimin e interesit publik dhe vlerësimin e efekteve mbi tregun dhe konkurrencën¹³.

Mbikëqyrje e dobët institucionale. Edhe pse sot shteti disponon me një numër dukshëm më të madh të institucioneve dhe mekanizmave mbikëqyrës, të pavarur dhe mbrojtës, krahasuar me periudhat e mëparshme të transformimit të pronësisë, ato sipas ligjit mbeten të përjashtuara nga procedura e vendimmarrjes për tjetërsim. Nuk është paraparë asnjë rol mbikëqyrës i Kuvendit, e as rol proaktiv i Entit Shtetëror për Revizion apo i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, qoftë përmes dhënies së një mendimi paraprak para marrjes së vendimit, revizionit të detyrueshëm ex post apo kontrollit të integritetit gjatë transaksioneve me rrezik të lartë.

Procedura e tjetërsimit. Përveç një kornize të përgjithshme, ligji nuk siguron rregullim mjaftueshëm të qartë dhe sistematik të mënyrës së tjetërsimit¹⁴. Ligji parashikon që aksionet, pjesëmarrjet në kapital dhe të drejtat themeluese tjetërsoren “në një procedurë publike, jodiskriminuese dhe konkurruese”, por nuk e rregullon vetë procedurën: përmes mbledhjes së ofertave publike, ankandit publik, negociatave të drejtpërdrejta, përmes bursës kur është e përshtatshme etj. Mënyrat, afatet dhe vetë procedurat e transformimit nuk rregullohen as në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe as në Ligjin për shoqëritë tregtare. Një rregullim i tillë i pamjaftueshëm e rrit diskrecionin e Qeverisë, lë hapësirë për praktikë të pabarabartë dhe krijon një mjedis të përshtatshëm për keqpërdorime. Kjo shmangie devijon nga parimi se garancitë thelbësore procedurale në procedurat me rrezik të lartë për keqpërdorim duhet të rregullohen me ligj, e jo me akt të organit i cili njëkohësisht vendos për disponimin.

Vlerësimi i vlerës. Vlerësimi joadekuat i vlerës ishte një nga rreziqet më të mëdha të korrupsionit gjatë transformimeve të mëparshme të pronësisë. Në vend që të parashikojë mbrojtje shtesë, ligji përcakton se vlerësimin e vlerës së aksioneve, pjesëmarrjeve në kapital dhe të drejtave themeluese e kryen “ministra kompetente ose organi shtetëror i autorizuar”¹⁵, përkatësisht i njëjti organ që e merr dhe e zbaton vendimin për disponimin. Ndryshe nga regjimi i mëparshëm, ku vlerësimi, të paktën formalisht, zbatohet përmes një procedure të

¹³Neni 22(3) dhe 25(4)

¹⁴Neni 24 dhe 25

¹⁵Neni 25(5)

veçantë dhe të institucionalizuar¹⁶, ligji e lë të gjithë procesin e vlerësimit pa verifikim të jashtëm dhe të pavarur, përkatësisht nuk kërkon zbatimin e Ligjit për Vlerësim ose angazhimin e një vlerësuesi të autorizuar.

NË VEND TË PËRMIRËSIMIT, REPLIKIMI I TË NJËJTIT SISTEM PËR PËRZGJEDHJEN E KUADROVE DREJTUESE

Ky ligj përcakton një regjim të vetëm juridik për organizimin dhe menaxhimin e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi të shtetit ose me pjesëmarrje të shtetit¹⁷¹⁸. Megjithatë, nëse e krahasojmë procedurën e përzgjedhjes të paraparë në këtë ligj me atë të përcaktuar me Ligjin e ri për menaxherët e lartë¹⁹, mund të konkludojmë se: nuk është përcaktuar se ku dhe për sa kohë duhet të publikohet konkursi, as përmbajtja e tij; nuk janë paraparë faza në procedurën e përzgjedhjes, e as testimi i kandidatëve; nuk është e qartë nëse dhe kush e kryen verifikimin administrativ të kandidatëve; nuk ekziston detyrim që Qeverisë t'i propozohen tre kandidatët më të renditur; dhe nuk është paraparë mbrojtje juridike kundër vendimit.

Kjo nuk do të thotë se ky ligj duhet ta kopjojë procedurën për menaxherët e lartë, por në kushtet kur përzgjedhja e organeve drejtuese është ndër kanalet më të dokumentuara të ndikimit politik mbi ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të shtetit, zgjidhjet e propozuara duhet të parashohin së paku një procedurë po aq transparente sa standardi që shteti tashmë vetë e ka përcaktuar me Ligjin për menaxherët e lartë.

ËSHTË E NEVOJSHME TË SIGUROHET ZBATIMI PËRKATËS I LIGJIT NË NIVEL LOKAL

Në grupin punues, IDSCS u angazhua që fushëveprimi i ligjit, veçanërisht në pjesën që ka të bëjë me përfshirjen në regjistër, avancimin e mbikëqyrjes, kontrollin e brendshëm dhe auditimin, t'i përfshijë edhe ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi ose me pjesëmarrje të komunave, për një regjim të vetëm dhe gjithëpërfshirës juridik. Ligji pjesërisht e adreson këtë: organ i të drejtave pronësore është Qeveria, organi i administratës shtetërore ose këshillat e komunave dhe Qyteti i Shkupit; politikën e pronësisë e miraton Qeveria, përkatësisht këshilli i komunës ose i Qytetit të Shkupit; menaxhimi i koordinuar i personave juridikë në pronësi ose me pjesëmarrje të shtetit kryhet përmes ministrive kompetente, ndërsa

¹⁶ Ligji për transformimin e kapitalit shtetëror ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/93, 48/93, 21/98, 25/99, 39/99, 81/99, 49/00, 6/02, 31/03, 38/04, 35/06, 84/07, 123/12 dhe 25/15)

¹⁷ Gjithashtu, ligji nuk bën klasifikimin e duhur terminologjik të organeve administrative që ndodhin në këto subjekte. Për shembull, ka mungesë të zbatimit të duhur të termit drejtor, i cili është një organ drejtues në ndërmarrjet publike.

¹⁸ Neni 3 përcakton se të gjitha çështjet që nuk rregullohen me këtë ligj do të rregullohen me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare, si dhe me ligje të tjera. Neni 42 përcakton kur nuk zbatohen dispozitat për zgjedhjen dhe emërimin, duke mos përfshirur ndërmarrjet publike. Neni 66 parashikon harmonizimin e ligjeve të veçanta brenda 1 viti.

¹⁹ Ligji për udhëheqësit e lartë (miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 26.06.2026). Në dispozicion në: <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nsp?param=95a8e595-fc9d-4ee2-a385-0f2c2f093fd2>

me personat juridikë të themeluar nga komunat ose Qyteti i Shkupit kryhet përmes subjektit të përcaktuar me vendim të këshillit të komunës ose të Qytetit të Shkupit²⁰²¹²².

Megjithatë, kjo dallueshmëri mungon në nenet kyçe të ligjit të miratuar, edhe pse ajo ishte e pranishme në versionet e mëparshme. Për shembull, është paraparë që ky ligj të zbatohet ndaj ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi ose me pjesëmarrje të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të cilat shteti ka ndikim dominues ose çfarëdo lloj pjesëmarrjeje, ndërsa nuk është përcaktuar në mënyrë eksplicite se zbatohet edhe ndaj subjekteve të themeluara nga komunat ose nga Qyteti i Shkupit²³. Për më tej, si organ për ushtrimin e së drejtës së pronësisë dhe të drejtave të tjera pronësore për personat juridikë me interes të veçantë dhe personat e tjerë juridikë është Qeveria. Përsëri, komunat dhe Qyteti i Shkupit nuk trajtohen si organe kompetente për ushtrimin e së drejtës së pronësisë²⁴, gjë që është jokonsistente me përkufizimin e dhënë më herët.²⁵

Për më tepër, ligji prezanton një kategori të re “persona juridikë me interes të veçantë”²⁶, e cila u referohet ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare që, në përputhje me kriteret për pronësi dhe pjesëmarrje, me vendim të arsyetuar të Qeverisë janë përcaktuar si të tilla. Megjithatë, komunat dhe Qyteti i Shkupit nuk kanë qasje në të njëjtën kategori. Nëse kriteret për pronësi dhe pjesëmarrje janë baza për fitimin e këtij statusi, përkatësisht janë baza mbi të cilën merret vendimi nëse shteti do të heqë dorë nga pronësia, atëherë nuk është e qartë përse i njëjti test nuk zbatohet edhe për personat juridikë të themeluar nga komunat. Nëse komunat duhet të zbatojnë një kriter tjetër në kuadër të politikës së pronësisë²⁷, ligji nuk e rregullon atë kriter dhe krijon një zbrazëti juridike. Në thelb, nuk është e qartë nevoja për futjen e kategorisë “persona juridikë me interes të veçantë”. Nëse çdo pronësi ose pjesëmarrje e shtetit justifikohet me kriteret për pronësi dhe pjesëmarrje, atëherë secili prej këtyre personave juridikë automatikisht do ta fitojë këtë status, gjë që e bën kategorinë të panevojshme. Ligji nuk i përkufizon se cilët janë “personat e tjerë juridikë” dhe, nëse ekzistojnë raste kur pronësia ose pjesëmarrja e shtetit përjashtohen nga regjimi i nenit 12 dhe i nënshtrohen rregullave të tjera, ligji duhet ta rregullojë këtë në mënyrë të shprehur.

Së fundmi, ligji parashikon që politikën e të drejtave pronësore në nivel të komunës ose të Qytetit të Shkupit, edhe pse e miraton Këshilli, e propozon Ministria e Ekonomisë dhe Punës²⁸, gjë që paraqet ndërhyrje në autonominë e pushtetit lokal.

²⁰Neni 4(10)

²¹Neni 22(1)

²² Neni 17

²³ Neni 2

²⁴ Neni 15

²⁵Neni 4(10)

²⁶Neni 4(7), 12

²⁷Neni 22(1)

²⁸Neni 22(1)

TRANSPARENCË ME PËRJASHTIME QË DËMTOJNË QASJEN NË INFORMATA ME KARAKTER PUBLIK

Sa i përket transparencës, është pozitive që ligji parashikon një evidencë publike në të cilën do të dokumentohet kapitali shtetëror, përkatësisht pronësia dhe pjesëmarrjet që disponon shteti. Për më tepër, ngarkohet Ministria e Financave që të publikojë raport të konsoliduar për punën financiare, ndërsa Ministria e Ekonomisë dhe Punës që të publikojë raport të konsoliduar për përmbushjen e qëllimeve financiare dhe jofinanciare të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi ose me pjesëmarrje të shtetit.

Megjithatë, mënyra se si tani është rregulluar transparenca në ligj për ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të shtetit, ose me pjesëmarrje të tij, ngre shqetësime për disa arsye. Së pari, nuk është riafirmuar se për ndërmarrjet publike vlejnë dispozitat e Ligjit për qasje të lirë në informacionet me karakter publik. Së dyti, ndërsa pranohet se edhe me ligje të tjera personat juridikë në pronësi të shtetit ose me pjesëmarrje të tij mund të kenë detyrime për publikimin e informacioneve dhe dokumenteve²⁹, megjithatë shqetësues është parashikimi i përjashtimeve që janë më të gjera se ato të përcaktuara me Ligjin për qasje të lirë në informata me karakter publik (LQLIKP). Kështu, personat juridikë, përfshirë edhe ndërmarrjet publike, të cilat i nënshtrohen Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik (LQLIKP), nuk janë të obliguara të publikojnë informacione që përbëjnë sekret afarist ose profesional. Kjo qasje shkakton konflikt të normave ligjore dhe dobëson regjimin e qasjes në informata me karakter publik. Në mënyrë ideale, fushëveprimi i Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik (LQLIKP) duhet të zgjerohet edhe ndaj shoqërive tregtare me ndikim dominues shtetëror, sipas shembullit të Ligjit për prokurime publike, ndërsa ky ligj, nëse dëshiron, mund të ofrojë në mënyrë shtesë një listë të informacioneve që personat juridikë janë të obliguar t'i publikojnë në mënyrë proaktive.

MUNDËSI E HUMBUR PËR PREZANTIMIN E PRAKTIKAVE TË MIRA ANTIKORRUPSION

Përveç sa u përmend më lart, në ligj mungojnë disa praktika të mira që synojnë parandalimin e konfliktit të interesit, rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e interesit publik. Së pari, mungon një kriter shtesë "infrastrukturë kritike" për përcaktimin e personave juridikë me interes të veçantë, duke pasur parasysh rëndësinë e vazhdimësisë së shërbimeve thelbësore për interesin publik dhe sigurinë³⁰. Për më tepër, ligji nuk parashikon detyrim që anëtarët e organeve drejtuese të paraqesin deklarata për gjendjen pasurore dhe interesat e tyre, as nuk vendos kufizime për ushtrimin e veprimtarisë pas përfundimit të funksionit të tyre³¹. Së fundmi, mungon edhe përfshirja e shoqërive tregtare në pronësi të plotë shtetërore në Regjistrin e të Punësuarve në Sektorin Publik, një mekanizëm i cili do të mund të shërbente si mbrojtje kundër punësimeve të motivuara politikisht.

²⁹ Neni 46 (3)

³⁰ Neni 12(2). *Propozim - ligji për Infrastrukturën Kritike (2022)*. Në dispozicion në:
https://sq.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_req_detail&itemid=77229

³¹ Neni 47 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

PROPOZIME PËR NDRYSHIME KONKRETE NË LIGJ

Për sa më sipër, propozojmë që ligji të ndryshohet dhe plotësohet me:

1. Vendimin përfundimtar për tjetërsimin e personave juridikë me interes të veçantë ta marrë Kuvendi, bazuar në mendimet paraprake të Entit Shtetëror të Revizionit, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pas kryerjes së analizës së efekteve sociale dhe konsultimeve publike;
2. Vlerësim të pavarur, të jashtëm të vlerës së aksioneve, pjesës dhe të drejtave themeluese në dispozicion;
3. Rregullimi me ligj (dhe jo me akt nënligjor) i procedurës së tjetërsimit (ofertë publike, ankand publik, bursë, negociata të drejtpërdrejta);
4. Zgjerimi i kategorisë “persona juridikë me interes të veçantë” edhe ndaj subjekteve në pronësi ose me pjesëmarrje të komunave dhe Qytetit të Shkupit, futja e një mekanizmi përkatës paralel ose heqja dorë nga përdorimi i këtij termi;
5. Harmonizimi i procedurës për përzgjedhjen e bordeve mbikëqyrëse dhe bordeve të drejtorëve në shoqëritë tregtare me pjesëmarrje shtetërore me standardet e përcaktuara tashmë në Ligjin për shërbimin e lartë udhëheqës (shpallje transparente, faza të përzgjedhjes, listë renditjeje, mbrojtje juridike);
6. Vendosja e deklaratave për gjendjen pasurore, kufizimi për ushtrimin e veprimtarisë pas përfundimit të funksionit dhe përfshirja në Regjistrin e të Punësuarve në Sektorin Publik;
7. Afirmimi dhe zgjerimi i fushëveprimit të Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik ndaj ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare me pjesëmarrje shtetërore.

RRETH PROJEKTIT

Ky dokument për politika publike është pjesë e projektit **"Nxitja e debatit mbi llogaridhënien dhe anti-korrupsionin"**, i cili synon të kontribuojë në proceset e reformave në Maqedoninë e Veriut duke forcuar rolin e Kuvendit në luftën kundër korrupsionit dhe krijimin e reformave në sundimin e ligjit, duke mundësuar dialogun midis partive dhe të rinjve, si dhe midis deputetëve dhe shoqërisë civile. Projekti është mbështetur nga Fondi Kombëtar për Demokraci.